



RAPORT

MBI PRIORITETET E QYTETARËVE TË MBLEDHURA PËRMES VOTIMIT ONLINE

NË BASHKINË KAMËZ

2019

Publikim i të dhënave të kërkesave të qytetarëve në projektin: “Përmirësimi i Procesit të Buxhetimit të Konsultuar dhe me Pjesëmarrje”

Në Bashkinë Kamëz

Të nderuar përfaqësues të pushtetit vendor,

Shoqata për Integrimin e Zonave Informale në partneritet me **Institutin AGENDA** dhe mbështetur nga **Qendra Ndërkombëtare Olof Palme**, ka zbatuar një projekt që ka si qëllim kryesor rritjen e ndikimit direkt të qytetarëve në hartimin e buxhetit të bashkive me anë të një instrumenti efikas. Për rritjen e aksesit të qytetarëve në hartimin e buxhetit të bashkive është krijuar platforma **www.buxhetim.al** ku cdo qytetar mund të shprehë preferencat e tij për buxhetin e bashkisë. Në bashkinë Kamëz platforma u shfrytëzua nga qytetarët gjatë periudhës 30 tetor - 20 dhjetor 2019. Të dhënat e mbledhura nga aplikacioni janë përpunuar dhe analizuar nga stafi dhe ekspertët e Institutit, duke nxjerrë edhe rezultatet mbi preferencat e qytetarëve që janë paraqitur më poshtë në këtë raport. Duke i shpërndarë këto të dhëna pranë drejtuesve të Bashkisë dhe Këshillit bashkiak, synohet informimi i autoriteteve mbi mendimet e shprehura nga qytetarët dhe mundësia që të merren parasysh në hartimin e buxhetit përfundimtar.

Të dhënat e mbledhura në Bashkinë Kamëz

Nga bashkia Kamëz 166 qytetarë janë përfshirë në plotësimin e formularit duke shprehur prioritetet e tyre mbi zërat e buxhetit, nga të cilët 58 janë *meshkuj* dhe 108 janë *femra*.




Figura 1.1 Gjinia e qytetarëve




Figura 1.2 Mosha e qytetarëve




Figura 1.3 Arsimimi i qytetarëve

- **Kategoritë e buxhetit**




Figura 1.4 Kategoritë e buxhetit

- **Nënkategoritë e buxhetit**

Zërat e buxhetit	Numri	Përqindja
Ndriçimi publik	80	16%
Ujësjetllës kanalizime	61	12%
Shërbimi i pastrimit	44	9%
Ndihma ekonomike	35	7%
Shërbimi i transportit	33	7%
Kopshte	33	7%
Investime në rrugë urbane, rurale, sheshe	26	5%
Organizimi i aktiviteteve kulturore	24	5%
Çerdhe	23	5%
Ndriçimi publik	80	16%

Tabela 1.1 Nënkategoritë e buxhetit

- **Prioritetet sipas gjinisë**




Figura 1.5

- Prioritetet sipas moshës**




Figura 1.6

- Prioritetet sipas arsimimit**




Figura 1.7

- **Sugjerimet e qytetarëve të Kamzës**

1. Sugjeroj hapjen e çerdheve shtetërore.
2. Të hapen çerdhe publike.
3. Duhet shtuar çerdhet publike. Nuk kemi ku t'i çojme fëmijët.
4. Këto janë 3 më minimalet dhe karta e studentit që të njihet dhe në linjat e urbanit.
5. Të vihet në përdorim pallati i kulturës me aktivitete për të rinjtë.
6. Duam kushte më të mira për shkollat, të ketë ngrohje për fëmijët. Të shtohen kopshtet.

7. Pallati i kulturës të vihet në shërbim të të rinjve, të ketë më shumë aktivitete rinore dhe biblioteka të jetë në shërbimin e nxënësve dhe studenteve.
8. Të vendosen kosha të mëdha për mbeturina por edhe kosha të vegjël nëpër rrugët kryesore. Të hapen çerdhe për fëmijët se nuk i përballojmë dot çmimet e privatit.
9. Duam më shumë aktivitete kulturore në qytet.
10. Bashkëpunimi me çdokënd në punë të mira, nxitja në edukatë, dituri, punë të mbara. Respete!
11. Më shumë investime në rrugë, nuk ka ndriçim. Kemi frikë të kalojmë mbasdite. Edhe kanalizimet duhen përmirësuar.
12. Kopshte dhe çerdhe të reja.
13. Dhe ndihma ekonomike.
14. Shërbimi i transportit për linjën Kamëz-Qendër nuk ka mirëmbajtje po të themi fare, si dhe më e rëndësishmja ka momente që mbushen plot edhe nuk mer dot frymë.
15. Nuk ka çerdhe publike.
16. Mungesa e ujit dhe kanalizimet.
17. Ka nevojë për kopshte çerdhe se nuk kemi ku t'i lejmë fëmijët.
18. Edhe kopshte dhe cilësia e tyre.
19. Kopshte çerdhe, ujësjellës kanalizime, ndriçimi, pastrimi i mbeturinave.
20. Kopshte dhe çerdhe për fëmijët.
21. Sinjalistika përmirësim dhe mirëmbajtje.
22. Çerdhe dhe kopshte shtetërore për fëmijët.
23. Edhe punësimi se nuk e keni nxjerrë këtu.



**Përmirësimi i Procesit të
Buxhetimit të Konsultuar
dhe me Pjesëmarrje**

**Improvement of Consulted and
Participatory Budgeting Process**